

V E N D I M
Nr.132, datë 6.3.1993

PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pasaportat diplomatike dhe të shërbimit lëshohen vetëm nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit.

2. Pasaportat diplomatike dhe të shërbimit nënshkruhen nga një prej zëvendësministrave të Punëve të Jashtme ose nga drejtori i Drejtorisë konsullore, apo me autorizim të të mësipërmeve, nga titullari i përfaqësisë diplomatike jashtë shtetit ose zëvendësi i tij.

3. Pasaportat diplomatike u jepen për të dalë jashtë shtetit personave që bëjnë pjesë në këto kategori:

a. Gjatë ushtrimit të funksionit ose misionit të tyre:

- Presidentit të Republikës.
- Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe zëvendësve të tij.
- Deputetëve të Kuvendit Popullor.
- Anëtarëve të Qeverisë dhe kryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.
- Zëvendësministrave, nënkryetarëve të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit dhe kryetarit të

Komitetit të Mbrojtjes së Mjedisit.

- Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- Kryetarit të Kryqit të Kuq Shqiptar.
- Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.
- Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit.
- Prokurorit të Përgjithshëm.
- Kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar.
- Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë.
- Kryetarëve të delegacioneve shtetërore ose qeveritare që dërgohen jashtë shtetit për vizita zyrtare a miqësore, për bisedime dhe nënshkrim marrëveshjesh ose për të marrë pjesë në punimet e organizatave a konferencave ndërkombëtare.

- Kryetarëve të partive politike të përfaqësuara në Kuvendin Popullor ose në Këshillin e Ministrave.

- Anëtarëve të personelit diplomatik a konsullor të përfaqësive diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë.

- Mjekëve të caktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit për të punuar pranë ambasadave tona jashtë shtetit.

- Funkionarëve të karrierës diplomatike dhe konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe korrierëve diplomatikë konsullorë.

- Oficerëve që shoqërojnë jashtë shtetit Presidentin e Republikës, Kryetarin dhe nënkryetarët e Kryesisë së Kuvendit Popullor, Kryeministrin ose anëtarët e qeverisë.

- Grave, djemve të mitur, deri në 18 vjeç, dhe vajzave të pamartuara, që bashkëjetojnë me ta, të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kryesisë të Kuvendit Popullor, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, anëtarëve të qeverisë dhe anëtarëve të personelit diplomatik ose konsullor të Republikës së Shqipërisë.

- Guvernatorit të Bankës.

- Funkionarëve ndërkombëtarë që kanë shtetësinë shqiptare, kur rëndësia e funksionit të tyre gjykohet e mjaftueshme nga Ministria e Punëve të Jashtme.

b. Pas përfundimit të funksionit të tyre:

- Presidentit të Republikës.

- Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor.
- Kryetarit të Këshillit të Ministrave.
- Ministrit të Punëve të Jashtme.

Kriteret e vendosura në pikën "b" të këtij vendimi nuk kanë efekt prapaveprues.

4. Pasaportat e shërbimit u jepen për të dalë jashtë shtetit personave që bëjnë pjesë në këto kategori:

Gjatë ushtrimit të funksionit ose misionit të tyre:

- Drejtorit të ATSH-së.
- Drejtorit të Radiotelevizionit.
- Drejtorëve të bankave shtetërore.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Postave dhe Telekomunikacioneve.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave të Shtetit.
- Drejtorit të Drejtorisë së Doganave.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.
- Drejtorit të Qendrës së Nxitjes së Investimeve të Huaja.
- Drejtorit të Drejtorisë së Statistikës.
- Drejtorit të Personelit në Kryeministri.
- Drejtorëve të drejtorive në ministri.
- Rektorëve e zëvendësrektorëve të universiteteve.
- Kryetarit dhe nënkryetarit të Komitetit Kombëtar të Energjisë.
- Afaristëve, sipas udhëzimit që do të nxjerrë Këshilli i Ministrave.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave të Shtetit.
- Nënkyetarëve, sekretarëve të përgjithshëm dhe shefave të sektorit të jashtëm të partive të

përfaqësuar në Kuvendin Popullor ose në qeveri.

- Zëvendëskryetarëve të Gjykatës së Kasacionit.
- Zëvendësprokurorëve të Përgjithshëm.

Shefave të kabinetit dhe këshilltarëve të Presidentit, të Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor dhe të Kryeministrit.

- Nënkyetarëve dhe drejtorëve të SHIK-ut.
- Kryetarëve të degëve të rendit dhe të SHIK-ut në rrethe.
- Kryetarit të Arbitrazhit të Shtetit.
- Kryetarit të Komitetit Olimpik, Sekretarit të Përgjithshëm të FSHF dhe trajnerit të ekipit kombëtar në futboll.

- Kryetarëve të partive politike që nuk përfaqësohen në Parlament ose në qeveri.

- Kryetarëve të këshillave të rretheve dhe kryetarëve të bashkive, si dhe personave të ngarkuar për marrëdhëniet me jashtë.

- Kryetarëve të komuniteteve fetare.

- Drejtuesve kryesorë (kryetar, zëvendëskryetar, sekretar) të Kryesisë së Bashkimeve Sindikale të përfaqësuar në shkallë vendi).

- Gazetarëve të ATSH, RTV dhe të atyre që punojnë në gazeta e që janë anëtarë të shoqatës së gazetarëve. Nuk përfitojnë pasaporta shërbimi gazetarët e gazetave private.

- Korrespondentëve të përhershëm të shtypit të akredituar në vende të ndryshme.

- Anëtarëve të delegacioneve shtetërore ose qeveritare që dërgohen jashtë shtetit për vizita zyrtare a miqësore.

- Zëvendës shefave të Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandantit të Gardës së Republikës.

- Shoferëve të Presidentit të Republikës, të Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor, të Kryetarit të Këshillit të Ministrave e të anëtarëve të qeverisë, si dhe të kryetarit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.

- Punonjësve administrativë e teknikë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të përfaqësive diplomatike, konsullore dhe tregëtare, si dhe bashkëshortëve, djemve deri në 18 vjeç dhe vajzave të pamartuara që bashkëjetojnë me ta.

- Kryetarëve të degëve rajonale të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.

- Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

- Drejtorit të parkut të delegacioneve.

5. Me autorizim të Presidentit të Republikës ose të Kryetarit të Këshillit të Ministrave mund të pajisen me pasaporta diplomatike ose shërbimi edhe persona që nuk janë përfshirë në pikat 3 dhe 4, kur çmohet se veprimtaria e tyre është në shërbim të çështjes kombëtare, shkencës e artit.

6. Lejohet vendosja e fotografive të fëmijëve nën 16 vjeç vetëm në pasaportat e grave të anëtarëve të personelit diplomatik ose konsullor të Republikës së Shqipërisë.

7. Pasaporta diplomatike ose e shërbimit duhet të tregojë cilësinë e mbajtësit të tyre. Afati i vlefshmërisë së pasaportës diplomatike dhe të shërbimit do të jetë deri në 5 vjet. Ai mund të zgjatet edhe 2 herë të tjera për periudha deri në 2 vjet.

8. Vetëm autoritetet e treguara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi mund ta zgjatin afatin në pasaportat diplomatike dhe të shërbimit.

9. Lëshimi i pasaportave diplomatike dhe të shërbimit ose zgjatja e afatit të vlefshmërisë së tyre bëhet kundrejt pagesës sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë. Këto pagesa përballohen nga organet, institucionet ose organizmat që kërkojnë lëshimin a zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së pasaportave për punonjësit e tyre.

10. Për shkeljen e normave të këtij vendimi zbatohen sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi